



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORATI

Nr./50 Prot

Tiranë më 11.01 2019

VENDIM

Nr. 1, datë 11.01.2019

Rektorati i Universitetit të Tiranës ka ndjekur me vëmendje, shqetësim dhe përgjegjshmëri protestën e studentëve për rritjen e cilësisë së arsimit të lartë, përmirësimin të kushteve të shkollimit, uljes së kostove dhe përjashtimit nga tarifat e studimit të studentëve. Për shkak të zgjatjes së protestës dhe bojkotimit të procesit mësimor nga një pjesë e studentëve, ai nuk është zhvilluar normalisht. Duke u nisur nga kjo situatë dhe për t'i dhënë mundësi përfundimit me sukses të këtij viti akademik, Rektorati i UT-ës në mbledhjen e datës 11.01.2019:

VENDOSI:

1. T'ju bëjë thirrje studentëve të Universitetit të Tiranës t'i rikthehen procesit mësimor, duke garantuar të drejtën e studentëve për zhvillimin normal të procesit mësimor duke respektuar nga ana tjetër edhe të drejtën e tyre për të protestuar.
2. Të marrë masa që të garantohet plotësimi i programit mësimor për vitin akademik 2018-2019, nëpërmjet zëvendësimit të orëve mësimore të parealizuara për shkak të protestës, duke përshtatur strukturën akademike të vitit 2018-2019.
3. Të marrë masa dhe të urdhërojë të gjitha strukturat e Universitetit të Tiranës për shtyrje të afati të pagesës së tarifave dhe për shtyrjen e procedurave të marrjes së dokumentacionit për përfitim burse dhe të studentëve të kategorive të veçanta.
4. Të marr masa për ngritjen e grupit të punës me përfaqësi nga secila njësi kryesore dhe të ftoj studentët të jenë pjesë e tij në përgatitjen dhe realizimin e një plani veprimi në shërbim të përmirësimin të veprimtarisë së Universitetit të Tiranës në tërësi dhe veçanërisht në çështjet që lidhen me mësimdhënien, kërkimin shkencor, administrimin dhe transparencën e të gjithë aktivitetit të institucionit.

Rektorati i Universitetit të Tiranës vlerëson se në këtë proces reformimi dhe përmirësimi të veprimtarisë së UT-ës, rolin vendimtar e ka personeli akademik i këtij universiteti, integriteti dhe autoriteti i të cilit duhet të mbrohet në të mirë të funksionimit normal dhe reformimit të institucionit.

